# Hysen Keta

DREJTUES I PROKURORISË SË RRETHIT PËRMET

Deklaratat e analizuara:

**15 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria Bruto është rritur 2.9 herë

+ 1,221,874 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

**Likuiditete në Bankë**




**Likuiditete në Cash**




**Pasuritë e Luajtshme**




**Pasuritë e Paluajtshme**




## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2003-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni | 24,393,173 | 54.18% |
| Mësimdhënia | 3,872,980 | 8.60% |
| Të ardhura nga pagat e familjarëve | 13,818,559 | 30.69% |
| Të ardhura nga qeraja | 1,380,000 | 3.07% |
| Fitimi nga shitblerja e automjeteve | 957,240 | 2.13% |
| Të ardhura të tjera | 600,000 | 1.33% |
| Total | 45,021,952 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

**Pa Probleme**

Në deklarimin për herë të parë, subjekti Hysen Keta, deklaron një shtëpi banimi me sipërfaqe 60 m2 të trashëguar - ndërsa në vitin 2016 deklaron se ky apartament është legalizuar (ndërtuar vetë në vitet 1996- 2003 në truallin e trashëguar nga babai me të ardhurat nga puna si avokat. Legalizuar me dt. 17.08.2016, zona kadastrale me vlerë 2,200,000 lekë).
Në vitin 2017, vajza e subjektit deklaron një apartament me sip 61.8 m2 blerë nga bashkëjetuesi në shumën 48,935 euro- por nuk ka të dhëna për burimin e të ardhurave të bashkëjetuesit.
Në të njëjtin vit, djali i subjektit deklaron huamarrje në shumën 10,000 euro nga daja, për qëllim rikonstruksion banese në pronësi të babait (subjektit Hysen Keta).
Gjendja e akumuluar Cash sipas vetëdeklarimeve periodike nga viti 2003 deri 2017 është në shumën 11,650,000 lekë, ndërkohë që sipas nenit 4/1 të ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, kufiri i lejuar për t'u mbajtur Cash është 1,500,000 lekë.